



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGGJITHSHËM

Nr. 4076/12 Prot.

Tiranë, më 24.11.2020

Lënda: *Njoftim për caktimin e një përfaqësuesi për të qenë i pranishëm në momentin e organizimit të shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së.*

Drejtuar: ZONJËS ERINDA BALLANCA
AVOKAT I POPULLIT

ZONJËS VITORE TUSHA
ANËTARE ME KOMPETENCA TË KRYETARIT TË GJYKATËS
KUSHTETUESE

ZONJËS NAUREDA LLAGAMI
KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

ZOTIT GENT IBRAHIMI
KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Tiranë

Të nderuar,

Siç dhe mund të jeni në dijeni sipas njoftimit të bërë publik, Presidenti i Republikës në mbështetje të nenit 149/d, pika 3, të Kushtetutës, nenit 221 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemin të drejtësisë”, të ndryshuar, ka vendosur të hedhë shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ditën e premte, **datë 4 dhjetor 2020, ora 11:00**, në sallën “Skënderbej”, në Institucionin e Presidentit të Republikës, me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1 Tiranë.

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 149/d, pika 3 të Kushtetutës, Institucioni i Presidentit të Republikës **njofton zyrtarisht nëpërmjet kësaj letre Avokatin e Popullit**, për të qenë i pranishëm si vëzhgues i të gjithë procedurës së hedhjes së shortit.

Duke mbajtur në konsideratë nevojën për respektimin e protokolleve shëndetësore dhe rregullave për shkak të situatës pandemike Covid-19, njoftohen dhe ftohen Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të dërgojnë **një përfaqësues** për të qenë i pranishëm përgjatë hedhjes së shortit. Sa më sipër lutemi dërgimin

e emrit të përfaqësuesit të institucionit tuaj, mosparaqitja e të cilëve nuk sjell pengesë për zhvillimin e procedurës së hedhjes së shortit.

Në çdo rast, momenti i hedhjes së shortit të ketë mbulimin e nevojshëm mediatik, si dhe janë marrë të gjitha masat që ky proces t'i nënshtrohet plotësisht parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit, dhe të bëhet e mundur ndjekja *live* dhe në kohë reale e procesit nga të gjithë institucionet, subjektet e interesuara dhe publiku, që për shkak të akteve ligjore kufizuese në fuqi për shkak të pandemisë, nuk e kanë të mundur ta ndjekin drejtpërdrejtë nga salla procesin e hedhjes së shortit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

